	Gustav Klimperbein nga Hermann Mensing übersetzt von Gladiola Sadiku
	I madh nuk është. As i vogël nuk është Nuk është budalla dhe sigurisht nuk është as i trashë. Por, i shëndoshë, i shëndoshë është ai. Pothuajse aq i shëndoshë sa një ari. Emri i tij është Gustav: Gustav Klimperbain.
	Gustavi jeton në një shtëpi në një qytet të madh. Kur Gustavi del nga shtëpia, gjithçka rreth tij është e madhe. E madhe dhe fine. Shtëpitë, makinat, njerëzit, madje edhe qentë, që bredhin jashtë, edhe të gjithë janë shumë të zënë. Gustavi jo.
	Gustavit i pëlqejnë pemë të mëdha, në të cilat mund të përkundesh, makina të mëdha, ku ka shumë vend, qen të mëdhenj, me të cilët mund të dalësh për t'u argëtuar si edhe librezat kursimi të majme, për të mos qenë më i varfër. I pëlqejnë gjithashtu edhe avionë të mëdhenj, feta të trasha buke me gjalpë, gjëra të fryra si edhe batanije të trasha. Dhe, mbi të gjitha ai e do mamanë e tij të trashë, babanë e tij gjithashtu të trashë, papagallin e tij të majmë si edhe tre peshqit e tij të kuq trashaluqë.
	Gjithçka do të ishte në rregull, nëse nuk do të ekzistonte ky problem: të hollët e tallnin atë. - Gustavi barkvarur, - thërrasin ata, sapo ai hyn në oborrin e shkollës. Por, edhe, - Gustavi barkderr! Ndonjëherë edhe: - Gustavi me barkun që i dridhet. Herë pas here edhe: - Gustavi me këmbët që i dridhen: Por, më me qejf ata e thërrasin atë: - Gustavi barkvarur. Barkvarur! Barkderr! Gjithçka duhet të mbahet e fshehur!



Ai e ka të vështirë ta durojë talljen.
 Por, ai nuk do t'i tregojë asgjë asnjëriu.
 As mamit dhe as babit. Ai do të gjejë një zgjidhje,
 por vetëm me veten e tij. Ai mediton e mediton.
 „Injoroje!“, - dëgjon një zë të brendshëm.
 „Injo, - çfarë?“
 „Roje!“, - i flet atij zëri i brendshëm përsëri.
 „I – njo -ro-je!“
 „Mos ia vër veshin! Mos dëgjo!“
 „Kaloje! Mbaroi!“ Ndoshta mundimi do ia vlente.
 Gustavi ulet gjithë pasditen te shkallët e derës së
 përparme blu dhe mendohet:



Kur bie mbrëmja në qytet, ai del fshehurazi nga dera
 e pasme te korridori, ngjit pa zhurmë shkallët, shkon
 në dhomën e tij dhe e mbyll atë nga brenda.

- Gustav, - e thërret mamaja.
 Asnjë përgjigje.
 - Gustav, me çfarë po merresh atje lart?
 Eja, ne do të hamë darkë.

Zorrët e Gustavit kërcasin si ata të një luani të uritur,
 por, Gustavi ka vendosur, të qëndrojë duke u
 menduar për aq kohë në dhomën e tij, sa të gjejë një
 zgjidhje, se çfarë duhet të bëjë.
 Por, pastaj vjen babai dhe e bind ta hapë derën.

- Çfarë po ndodh? - pyet ai.
 - Grrr, - bën Gustavi.
 - I zemëruar?
 - Grrr!
 Dhe meqë kjo e bëri të ndjehej mirë, ai u tregon
 prindërve të gjithë historinë.
 - Oj, oj, oj, - tha babai dhe kruan kokën.
 Ta marrë dreqi, - tha nëna.




Papritur dëgjon në derë një të lehur frikësuese.
 - Po shoh njëherë, çfarë po ndodh, - thotë
 Gustavi. Ai nuk ka aspak frikë.
 Ai thjesht shkon te dera e përparme blu dhe e hap
 atë. Dhe, pastaj sheh atë!
 Thatanikun!
 Thatanikun e hollë sa gishti i vogël!
 Të madhin!
 Të madhin sa një gjigant.
 Të frikshmin!
 Më të frikshmin qen të të gjitha kohërave.

	Ky qen qëdron ulur atje. Gustavi e vështron atë. Edhe qeni e vështron. Gustavi thotë: - Mirëdita. - Ham, - thotë qeni dhe fillon të tundë bishtin me gëzim. - Asnjë rrezik, - i thotë Gustavi njerëzve në shtëpi, - është vetëm një qen. Eja, - thotë Gustavi.
	Qeni e kalon Gustavin dhe marshon për në kuzhinë. - Atje, atje është një qenush, - thotë mamaja e Gustavit e trembur. Qenushi ngrihet mbi putrat e pasme, vendos putrat e përparme në shpatullat e saj dhe e lëpin me gjuhë në të gjithë fytyrën.
	Qeni ka sy aq të mëdhenj sa një vezë pashke. Dhe një gojë aq të madhe sa të një peshkaqeni dy metra. Veshët e tij janë aq të mëdhenj sa të një llapushi. Gëzofi i tij është i shpupuritur dhe bishti i tij aq i hollë sa një bisht miu.
	„Ham“, - bën ai, ulet dhe i shikon të gjithë miqësisht. Babai i Gustavit zgjat dorën me kujdes dhe e ledhaton atë në kokë. Qeni fillon të dridhet nga gëzimi. Mamaja e Gustavit ia ngul sytë atij. Gustavi lumturohet sikur të ishte në qiellin e shtatë. Këtë qen ai nuk do ta lejojë të ikë, asnjëherë. - Ai është kaq i dobët, - thotë mamaja e Gustavit, - me siguri ka uri. Ham, - thotë qeni.
	Gustavi i jep atij darkën. Një pjatë spaghetti me mish të grirë. Qeni e boshatisi me një të gëlltitur pjatën. Qeni u ngjesh te Gustavi dhe e shikon atë me ata sytë e tij gjigantë.



Është e qartë, që qeni fle në dhomën e Gustavit.
Është e qartë, që Gustavi i tregon atij gjithçka rreth vetes së tij.
Është e qartë, që Gustavi i vë atij një emër.
Ai e quan atë Thatanik!
Qenit i pëqen ky emër.
Kur Gustavi e thërret atë Thatanik, ai tund bishtin.
Kur Gustavi i thotë:
- Thatanik ulu!, - ai ulet.
Kur Gustavi i thotë:
Thatanik bëhu i bukur!, - ai bëhet i bukur.



Të nesërmen kur Gustavi bëhet gati për në shkollë, Thataniku do të shkojë me të.
- Kjo nuk është e mundur, - thotë Gustavi.
Thataniku hungërin.
- Vërtet! - thotë Gustavi.
Thataniku i nxjerr atij dhëmbët e tij të rrezikshëm.
- Ti duhet të qëndrosh këtu! - thotë Gustavi, - unë do të kthehem shumë shpejt përsëri këtu.
Flokët në qafën e Thatanikut ngrihen përpjetë.
Gustavit nuk i mbetet gjë tjetër, përveçse ta lidhë Thatanikun te këmbët e krevatit të tij.
Thataniku rënkon, kur ikën Gustavi.



Në shkollë është gjithçka si përherë.
- Barkvarur!
- Barkderr!
- Gjithçka duhet të mbahet e fshehur! – bërtasin fëmijët
Gustavi provon të bëjë atë, që kishte planifikuar të bënte. Nuk i dëgjon, çfarë thonë.
Bën sikur nuk i intereson aspak, ajo që thonë ata.
Kjo nuk është e thjeshtë.
Dhe, të mosreaguarit ndaj sharjeve funksionon më mirë në pushimin e gjatë.

	Ndërkohë që Hansi e thërret Gustavin barkvarur, një hije gri si agimi i një mëngjesi fluturon vetëtimthi në oborrin e shkollës dhe qëndron përpara Hansit. Hija hungërin. Hans Lange zbehet. Fytyra i ngriu nga habia. Hija tregon dhëmbët e tij të rrezikshëm. Hans Lange ngrin. Gustavi e njohu hijen. - Thatanik, ndalo! - bërtet ai. Hans Lange ulet. Por, jo ti! – thotë Gustavi.
	Hans Lange qëndron i ulur në oborrin e shkollës. Thataniku është i ulur pranë tij. Gustavi vjen. - Thatanik! - thotë ai, - nga po vjen ti? Thataniku dridhet nga gëzimi dhe fërkon turirin e tij tek hunda e Gustavit. Hans Lange ngrihet me kujdes. - Gustav, i yti është ky? - pyeti ai. „A e dëgjova mirë?“ - mendon Gustavi. „Më thërriti Gustav, ai?“
	- A është ky qeni yt? – pyet përsëri Hansi. - Jo! - thotë Gustavi, - pooo! - Unë, unë, eh, nuk e di akoma! - Epo, çfarë pra, barkderr? Hansi nuk kishte mbaruar së foluri, kur Thataniku i tregon përsëri dhëmbët. Dhe jo vetëm kaq. Thataniku kap fundin e pantallonave të Hansit dhe e tërheq fort atë. Aq fort sa Hansi rrëzohet mbi të ndenjurat.
	- Qen i mirë! - thotë Hansi duke iu përgjëruar, - qen i sjellshëm! - Thatanik, eja, lëre atë! - thotë Gustavi. Pushimi mbaroi. Thataniku qëndron i ulur te dera e shkollës dhe pret. Gustavi ia tha atij këtë gjë. Në klasën e Gustavit flitet vetëm për Thatanikun. Duan të dinë, nga vjen. Si quhet. Sa vjeç është. Dhe nëse kafshon njerëz, e kështu me radhë. - Po, - thotë Gustavi, - ai edhe mund të kafshojë njerëz. Barkderri ka një ngrënës njerëzish!



Në atë moment dëgjohej nga larg një e lehur aq e tërbuar, saqë të gjithë ngrinë.

- Epo, thotë Gustavi, Thatanikut nuk i pëlqen, kur ju më thërrisni barkderr!
- Por kjo është vetëm shaka! - i thonë ata.

Shaka e bukur, - thotë Gustavi, - por mua nuk më vjen për të qeshur.



Shkolla mbaroi.

Thataniku e përshëndet Gustavin.

Bishti i hollë sa i një miu tundet andej këndeje.

Sytë e mëdhenj shkëlqejnë nga gëzimi.

- Eja, - thotë Gustavi, - për në shtëpi. Fëmijët i ndjekin ata me vështirime.

Një qen të tillë, do ta dëshironin edhe ata.



Fund